

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**« XPRESS LOGISTICS » Sh.p.k**

Në Durrës, sot më datë 27.06.2022 (dymijë e njëzetë e dy) :

- Dritan Sinani**, i lindur më 21.09.1985, në Elbasan, dhe banues në Rruga Bajram Curri ,Lagjja13 , Durrës, shtetas shqiptar, i identifikuar nëpërmjet leternjoftimit me nr.personal I50921163K, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar; Cel : 0699976256, email: [dritansinani3@gmail.com](mailto:dritansinani3@gmail.com) ;
- Adisa Myftaraj**, e lindur më 22.08.1984 , në Durrës dhe banues në Rruga Dhimitër Kulla 12 Durrës , shtetas shqiptar , i indentifikuar nëpërmjet leternjoftimit me nr.personal I45822073W, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar; Cel:0696048458, email: [myftarajadisa@gmail.com](mailto:myftarajadisa@gmail.com) ;

Vendosi sa vijon:

**NENI 1**

Themelohet shoqëria tregtare : «Xpress Logistics» shpk.

Ortakët themelues të saj janë:

- Dritan Sinani**
- Adisa Myftaraj**

Shoqeria tregtare « Xpress Logistics » do të jetë shoqëri me përgjegjesi të kufizuar. Emërtimi i shoqërisë do të jetë i stampuar dhe në vulën e saj.

**NENI 2**

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: “Rruga Tre.Vell.Thanasi Hyrja 1,Zona Kadastrale Nr. 8518.Nr.i Pasurise 37/151+1-5.Durrës.”

**NENI 3**

Shoqëria e shtrin aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë shtetit. Me vendim të ortakëve, mund të krijohen ose anullohen (në rast se janë çelur), seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Njësitë e tjera strukturore të shoqërisë si degë apo përfaqësi edhe jashtë shtetit krijohen kur një gjë të tillë parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

---

**NENI 4**  
**Kapitali i shoqërisë**

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 1.200.000 lekë,formuar nga ortaku themelues, i ndarë në 2 (dy) kuota, zotëruar nga ortaku themelues z.Dritan Sinani me vlerë të përgjithshme 720.000 lekë dhe përbën 60 % të kapitalit të shoqërisë si dhe ortaku themelues Adisa Myftaraj me vlerë të përgjithshme 480.000 lekë dhe përbën 40 % të kapitalit të shoqërisë.

Shoqëria mund të ndryshojë kapitalin themeltar; Transferimi i kuotave kushtëzohet nga e drejta e parablerjes në favor të ortakëve të tjerë;

Po kështu transferimi i Kuotave bëhet sipas neneve 72; 73 ;74 ;75 dhe përgjithësisht siç parashihet në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008. Të gjitha transferimet kanë efekt mbi shoqërinë që nga momenti i regjistrimit në librin e Ortakëve.

Ortakët kanë të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjeti xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

#### **NENI 5**

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është pa afat.

#### **NENI 6**

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me Legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe mbi bazën e këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

#### **NENI 7**

Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme në rrugë trashegimie, në përputhje me ligjin dhe statutin.

#### **NENI 8**

Shoqëria « Xpress Logistics » Sh.p.k, krijuhet për të ushtruar aktivitetin e saj konform objektit që do të jetë:

**“Ofrimi i shërbimit të trasportit si dhe ndërmjetësimi i shërbimit të trasportit”.**

#### **NENI 9**

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar dhe në drejtimet të tjera të cilat janë me interes për mbarëvajtjen e shoqërisë.

#### **NENI 10**

Me vendim të Asamblesë së ortakëve, shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose me shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptare apo të huaj, ose të bashkohet me shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë saj.

#### **NENI 11**

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është Organi me i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që ligji " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare " i njeh asamblesë së ortakëve që janë krijuar me ortakëri.

Ortakët mund t'ia delegojnë kompetencat një ose më shumë administratorëve të caktuar prej tyre ose dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë.

#### **NENI 12**

Administrator i shoqërisë « Xpress Logistics » Sh.p.k, emërohet:

**Dritan Sinani**, i lindur më 21.09.1985, në Elbasan, dhe banues në Durrës, shtetas shqiptar, i identifikuar nëpërmjet leternjoftimit me nr.personal I50921163K, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar; Cel:0699976256, email: [dritansinani3@gmail.com](mailto:dritansinani3@gmail.com) ;

Administratori i shoqërisë, **Dritan Sinani**, emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar nga data e nënshkrimit të këtij akti.

### NENI 13

Ky Akt Themelimi hartohet në 3 kopje origjinal, me të njëjtën vlerë ligjore, një kopje depozitohet në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit.

Ky akti u lexua dhe u kuptua nga nënshkruesi i cili deklaron se akti është i rregullt tërësisht dhe në çdo paragraf në përputhje me vullnetin e lirë e të plotë të tij,  
Nënshkruesi jep pëlqimin për sa përmendet në akt dhe e nënshkruan rregullisht në çdo faqe dhe emër, mbiemër dhe firmë në mbyllje të aktit.

**ORTAKU**  
**Dritan Sinani**

Dritan Sinani



**ORTAKU**  
**Adisa Myftaraj**

Adisa Myftaraj

